

ANALIZA E VROJTIMIT TË TREGTISË SË JASHTME

*- llogaritja e koeficientëve vlerësues për koston e transportit
dhe sigurimit të mallrave.*

ARGITA FRASHËRI, ERMAL HITAJ

Mars 2003

Abstrakt: Analiza e mëposhtme ka si qëllim rivlerësimin e koston së transportit dhe sigurimit të importeve dhe eksporteve shqiptare, që aplikohen në Bilancin e Pagesave. Efektet e këtij rivlerësimi në Bilancin e Pagesave do të përqëndrohen mbi zërat e importit të mallrave si dhe në shërbimet e transportit dhe të sigurimit. Në këtë analizë përfshihet, gjithashtu, një vlerësim mbi efektin e kontrabandës në tregti, një vlerësim mbi kohëzgjatjen e ciklit tregtar si dhe mbi mënyrën e pagesës në transaksionet tregtare.

Përmbledhje

Kërkesa për transport lind bashkë me mundësitë për tregti. Transporti mundëson tregtinë duke integruar tregjet me njëri-tjetrin dhe duke kapërcyer distancat hapësinore midis kërkesës dhe ofertës.

Kostoja e transaksionit, pjesë e të cilës është edhe kostoja e transportit, zë një vend veçanërisht të rëndësishëm në literaturën ekonomike. Kjo për faktin se, qoftë gjatë procesit të përpunimit dhe shndërrimit të lëndëve të para në të mira konsumi ose prodhimi, qoftë gjatë tregtimit të këtyre të mirave konsumatoreve, hasen një sërë kostosh jashtë procesit teknik, që kanë lidhje kryesisht me sigurimin e informacionit për tregjet, transportin dhe sigurimin e aktivitetit ndaj rrezikut dhe pasigurisë.

Kostoja e transportit përbën një pjesë të rëndësishme të kostos së transaksionit, dhe ndyshe nga përbërësit e tjerë të saj është më e matshme dhe reflektohet drejtpërsëdrejti në çmimin final të mallit. Si e tillë, kostoja e transportit ka lidhje edhe me avantazhin krahasimor të një vendi, p.sh. një kosto relativisht e lartë e transportit e pjesës dërrmuese të mallrave të prodhuara në një vend do të zbehte dukshëm efektin e avantazheve krahasimore në tregtinë e vendit.

Duke marrë parasysh rëndësinë e kostos së transportit si dhe nevojshmerinë e rivlerësimit të saj për efekt të Bilancit të Pagesave dhe duke synuar vlerësimin e importeve në vlerën f.o.b. (free on board) konform metodologjisë bazë të Manualit të Bilancit të Pagesave, u pa i domosdoshëm vrojtimi mbi koston dhe aspekte të tjera të transportit.

Duke qenë se kostoja e sigurimit ka efekt të ngjashëm me atë të transportit mbi vlerën finale të mallit, u vendos që edhe ajo të përfshihej në objektivat e vrotimit.

Në dritaren e mëposhtme është paraqitur në mënyrë të përmbledhur aplikimi i kostove të transportit dhe sigurimit të mallrave në Bilancin e Pagesave sipas koeficientëve që aktualisht përdoren .

Box 1. Aplikimi i kostove të transportit dhe të sigurimit të mallrave në Bilancin e Pagesave.

Bilanci i pagesave (BP) si një pasqyrë statistikore që pëmbledh për një periudhë të përcaktuar kohore, transaksionet¹ ekonomike të një ekonomie me botën e jashtme përfshin, njëkohësisht, transaksionet e kryera gjatë transportimit dhe sigurimit të mallrave. Në kategorinë *mallra* të BP përfshihen importi dhe eksporti i mallrave, të cilat në bazë të standarteve të BP vlerësohen në vlera f.o.b². Statistikat e tregtisë së jashtme në mallra ofrohen nga DPD: eksportet në vlerë f.ob. dhe importet në vlerë c.i.f³.

Më poshtë paraqitet aplikimi i kostove të transportit dhe të sigurimit të mallrave në BP.

Llogaria Korente

1. **Mallra**

2. **Shërbime**

2.a. **Shërbime transporti**

(i) **Navllo**

(ii) **Pasagjerësh**

(iii) **Të tjera**

2.b. **Sigurimi**

vlerësimi i importeve në f.o.b pas deduktimit të 7% të vlerës (c.i.f) si kosto transporti dhe 3% të saj si kosto sigurimi.

në kredit: 3% e totalit të eksportit si shërbim transporti.

në debit: 7% e totalit të importit (c.i.f) si shërbim transporti.

në debit aplikohet 3 % e vlerës totale të importit (c.i.f) si tarifë për sigurimin e mallrave.

¹*Transaksioni* në vetvete përcaktohet si një fluks ekonomik që reflekton krijimin, transformimin, shkëmbimin, transferimin apo "shkatërimin" e vlerave ekonomike dhe përfshin ndryshimin e pronësisë së mallrave dhe/apo të mjeteve ose detyrimeve financiare, ofrimin e shërbimeve ose të fuqisë punëtore dhe të kapitalit, mes rezidentëve dhe jorezidentëve.

² **F.o.b. (free on board):** vlerësimi i mallrave në çmim tregu, në kufirin e ekonomisë nga e cila janë eksportuar, duke përjashtuar shërbimet e transportit dhe të sigurimit.

³ **C.i.f. (cost, insurance and freight):** vlerësimi i mallrave në çmim tregu, në kufirin e ekonomisë në të cilën importohen, duke përfshirë koston e transportit dhe të sigurimit.

Ndërmarrja e Vrojtimit të lartpërmendur u pa e nevojshme nga ana e sektorit të Bilancit të Pagesave sepse në formularët aktualë të deklaratave doganore tregtarët nuk janë të detyruar të japin informacion të detajuar mbi koston e transportit dhe sigurimit të mallit.

Ky studim paraqet metodologjinë dhe rezultatet e vrojtimit si dhe përbën një pikënisje për analizën e impakteve të ndryshimit të koston së transportit dhe sigurimit në llogaritë e Bilancit të Pagesave.

Materiali është strukturuar me dy pjesë kyesore:

Pjesa e parë, përmban qëllimin e vrojtimit dhe metodologjinë e aplikuar, ku shpjegohen, në mënyrë të detajuar, hapat e ndërmarrë për realizimin e vrojtimit dhe për përfundimin e një rezultati statistikor sa më domethënës.

Pjesa e dytë, përmban rezultatet e dala nga analiza sistematike e rubrikave. Kjo pjesë është strukturuar në përputhje me strukturën e pyetësorit dhe analizon rezultatet e nxjerra nga rubrikat e vecanta të tij, të listuara si më poshtë:

1. *Të dhëna të përgjithshme mbi transaksionin tregtar*, e cila jep një informacion të përgjithshëm lidhur me volumin e transaksioneve (në f.o.b. dhe c.i.f.) të rezultuara nga vrojtimi.
2. *Të dhëna për transportin e mallrave*, analiza e së cilës përbën qëllimin kryesor të ndërmarrjes së këtij vrojtimi. Rubrika është e ndarë në dy pjesë kryesore, njera prej të cilave i adresohet importeve dhe tjetra eksporteve. Duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar, **kostoja e transportit të mallave në importe rezultoi 12.05 përqind (nga 7 përqind që aplikon sektori i BP aktualisht)**. Me të njëjtën mënyrë përlllogaritjeje, **kostoja e transportit të mallrave në eksporte rezultoi në nivelin 8 përqind**.

Nga analiza e informacionit të marrë rezultoi se, si në importe ashtu edhe në eksporte, në mëse 2/3 e rasteve kostoja e transportit është përballuar nga pala shqiptare. Shpërndarja e përballimit të koston së transportit sipas konceptit të rezidencës, si dhe informacioni i mbledhur gjatë takimeve me agjencitë e speditonit në vend¹, shërbyhen si bazë në përlllogaritjen e zërit përkatës në seksionin e shërbimeve në BP (në fund

¹ Duke qenë se shërbimet e transportit ofrohen në masë të konsiderueshme nga agjenci speditonit shqiptare, të cilat operojnë në bashkëpunim me kompani jorezidente, pagesat përkatëse shpërndahen si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Për të përcaktuar raportet e kësaj shpërndarjeje është marrë kontakt me agjencitë e speditonit, të regjistruara pranë Ministrisë së Transportit. Gjithashtu, një tjetër interesim i yni ishte marrja e opinioneve mbi firmat e huaja transportuese, që operojnë në tregun e transportit të mallrave (për të patur një vlerësim mbi pjesën e tregut që mbulojnë kompanitë e huaja të transportit dhe atë që mbulojnë ato shqiptare).

të kësaj përmbledhjeje do të gjeni Box 2. ku paraqitet impakti i aplikimit të koeficientëve të nxjerrë nga vrojtimi në Bilancin e Pagesave, ilustrim për vitin 2002).

Si në importe ashtu edhe në eksporte në shumicën dërrmuese të rasteve tregtia është kryer nëpërmjet transportit rrugor (ku përfshihen edhe kamionët e transportuar me tragete).

3. *Të dhëna për sigurimin e mallrave*, edhe kjo e ndarë në dy pjesë kryesore, njëra prej të cilave i adresohet importeve dhe tjetra eksporteve. Një aspekt karakteristik i gjetjeve tona për këtë rubrikë është fakti që, në shumicën e rasteve mallrat nuk janë siguruar. Përsa i përket tarifës së sigurimit të mallrave të rezultuar nga vrojtimi dhe të konfirmuar nga takimet direkte me agjencitë kryesore të sigurimit, përfundimi ynë është që **kostoja e sigurimit të mallrave nuk kalon 1 përqind të vlerës së mallit**. Kjo çon në përfundimin se vlera prej 3 përqind që aplikohet aktualisht nga BP është e mbivlerësuar.
4. *Të dhëna për mënyrën e pagesës*, nga e cila rezulton se në masë të konsiderueshme tregtia kryhet në *cash*.ë dhëna për *kreditë tregtare*, rubrikë për të cilën nga vrojtimi nuk u arrit të mblidhej informacion.
5. *Intervistë e përgjithshme*, në të cilën u mblodh informacion për ciklin tregtar të mallrave (i cili rezultoi mesatarisht 49.5 ditë) dh e kontrabandën, e cila u vlerësua në masën 17 përqind të importeve.

Box 2. Impakti i aplikimit të koeficientëve të nxjerrë nga vrojtimi, për transportin dhe sigurimin e mallrave, në Bilancin e Pagesave.

-Ilustrim për vitin 2002.

Aplikimi i koeficientëve të nxjerrë nga vrojtimi (si kosto për transportin dhe sigurimin e mallrave) do të japë një efekt të agreguar në *llogarinë korente* të Bilancit të Pagesave.

Më poshtë paraqitet ndikimi që do të rezultojë nga zëvendësimi i koeficientëve që përdoren aktualisht nga BP me ata të përlogaritur nga vrojtimi. Ilustrimi bëhet për vitin 2002. Llogaritë e ndikuara do të jenë:

- *Mallra*: Vlera e *importeve* në f.o.b, pas deduktimit të 12.05 për qind të vlerës c.i.f. si kosto transporti dhe 1% të saj si kosto sigurimi, për vitin 2002, rezulton në 1435.9 nga 1485.4 milionë dollarë, duke shkaktuar një ulje prej 49.5 milionë dollarë të *importeve* dhe një reduktim prej 4.3 për qind të *deficitit tregtar*.
- *Shërbime*: Ndikimi do të jetë i dyanshëm, pra do të bjerë si mbi kreditin ashtu edhe debitin e llogarisë *shërbime*.
 1. *shërbime transporti mallrash, "navllo"*. Nga aplikimi i koeficientëve të përlogaritur mbi përballimin e koston së transportit të mallrave nga palët rezidente dhe jorezidente rezulton rënia e shpenzimeve për transport mallrash me 5.8 milionë dollarë (debiti i zërit *shërbime transporti mallrash*) dhe njëkohësisht rritja e të ardhurave nga ofrimi i shërbimit të transportit (kreditin e zërit *shërbime transporti mallrash*) me 31.2 milionë dollarë.
 2. *shërbime sigurimi*. Një pjesë e shpenzimeve për sigurim (debiti i këtij zëri) vlerësohet me 3 % të vlerës c.i.f të importit si tarifë për sigurimin e mallrave. Aplikimi i koston prej 1% të sigurimit sipas vrojtimit çon në reduktimin me 30 milionë të shpenzimeve për sigurim.

Efekti i agreguar i aplikimit të koeficientëve të përlogaritur nga vrojtimi në *llogarinë shërbime* çon në mbylljen e kësaj llogarie me një suficit prej 61.8 milionë dollarë nga një deficit prej 5.2 milionë dollarë.

Rrjedhimisht, aplikimi i kostove të nxjerra nga vrojtimi, për transportin dhe sigurimin e

Tabela 1. Llogaria korente në Bilancin e Pagesave për vitin 2002, në milionë dollarë.

	2002		2002 Ilustrim	
A. Llogaria korente	1733.9	-2154.8	1764.7	-2069.5
Mallra, shërbime dhe të ardhura	1062.2	-2096.2	1093.4	-2010.9
1. Mallrat sipas Bilancit të Pagesave	330.2	-1485.4	330.2	-1435.9
1a.Mallra të përgjithshme	330.2	-1472.4	330.2	-1423.3
1b.Mallrat nga ndihmat		-13.0		-12.5
1c.Mallrat nga migrantët		0.0		0.0
2. Shërbime	585.0	-590.3	616.3	-554.5
2a. Transporti	18.8	-127.7	50.1	-122.0
i. Navllo	9.9	-105.1	41.1	-99.3
ii. Pasagjerësh	4.6	-21.2	4.6	-21.2
iii. Të tjera	4.3	-1.4	4.3	-1.4
2b. Sigurimi	1.0	-49.2	1.0	-19.1
2c. Udhëtime	486.9	-365.5	486.9	-365.5
i. Biznes	234.9	-172.1	234.9	-172.1
ii. Personal	252.0	-193.4	252.0	-193.4
2d. Shërbime të tjera	78.3	-47.9	78.3	-47.9
i. Shërbime komunikacioni	32.6	-10.1	32.6	-10.1
ii. Shërbime kompjuteri	0.5	-1.0	0.5	-1.0
iii. Asistencë teknike	0.0	-7.9	0.0	-7.9
iv. Shërbime qeveritare	10.5	-7.6	10.5	-7.6
v. Shërbime financiare	9.9	-1.2	9.9	-1.2
vi. Shërbime biznesi kulturore dhe personale	2.5	-6.6	2.5	-6.6
vii. Të tjera	22.3	-13.5	22.3	-13.5
3. Të ardhura	146.9	-20.6	146.9	-20.6
3a. Shpërblimet e punonjësve	88.8	0.0	88.8	0.0
3b. Të ardhura nga investimet	58.1	-20.6	58.1	-20.6
i. Të ardhura nga Investimet e Huaja Direkte	0.0	-0.6	0.0	-0.6
- dividendi	0.0	-0.6	0.0	-0.6
ii. Të ardhura nga Investime të Portofolit	20.3	0.0	20.3	0.0
kapitali	0.0	0.0	0.0	0.0
interesi	20.3	0.0	20.3	0.0
iii. Të ardhura nga rezervat	37.8	-1.5	37.8	-1.5
iv. Të ardhura të tjera (borxhi)	0.0	-18.5	0.0	-18.5
4. Transferta korente	671.7	-58.5	671.3	-58.5
4a. Qeveria e përgjithshme	39.9	-1.7	39.4	-1.7
i. Asistencë teknike	23.4	0.0	23.4	0.0
ii. Ndihma në Cash	0.8	0.0	0.8	0.0
iii. Mallra dhe të tjera ndihma	15.7	-1.7	15.3	-1.7
4b. Dërgesa nga ish-rezidentët	631.5	0.0	631.5	0.0
4c. Të tjera	0.3	-56.9	0.3	-56.9
BILANCI I LLOGARISË KORENTE	-420.8		-304.8	
-përrjashtuar transfertat shtetërore	-460.7		-344.2	

Qëllimi i vrojtimit

Qëllimi i organizimit të vrojtimit është rivlerësimi i statistikave të Bilancit të Pagesave për transaksionet që lidhen me tregtinë e jashtme. Nga ky vrojtimit synua të nxirrej informacion mbi: (i) koston e transportit dhe sigurimit të mallit, (ii) mënyrën e financimit dhe shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga transaksionet e tregtisë së jashtme, (iii) ciklin tregtar të mallrave, si dhe (iv) një vlerësim indirekt mbi shkallën e kontrabandës.

Metodologjia e vrojtimit

Vrojtimi u realizua në këto faza:

1. Përgatitja e pyetësorëve për vrojtimit.
 2. Zgjedhja e popullatës për intervistim.
 3. Trainimi i intervistuesve.
 4. Pastrimi dhe hedhja e informacionit.
 5. Përpunimi statistikor dhe analiza e rezultateve.
-
1. *Formulimi i pyetësorëve.* Nisur nga baza e gjërë e informacionit të kërkuar, pyetësi² është konceptuar në 6 rubrika. Çdo rubrike është strukturuar në pyetje, të cilat mbledhin informacion për problemin përkatës. Duke gjykuar synimin final të vrojtimit, përgjithësisht, informacioni kërkohet i natyrës sasiore dhe që merr informacion të vlefshëm për konkluzione të përgjithshme. Çdo pyetësor plotësohet për një trasaksion të tregtisë së jashtme (një deklaratë doganore), eksport ose import, në pikat doganore (të hyrjes apo të daljes).
 2. *Zgjedhja e popullatës për intervistim.* Për arritjen e qëllimit të vrojtimit u gjykua i përshtatshëm përfaqësimi në të i të 98 grupmallrave të Sistemit të Harmonizuar në importe dhe në eksporte. Zgjedhja e popullatës për vrojtimit u përcaktua nisur nga regjistrimet e tregtisë së jashtme për vitin 2001. Popullata përfaqëson të 98 grupmallrat e Sistemit të Harmonizuar, sipas peshës specifike të tyre në totalin e tregtisë. Vëllimi i zgjedhjes për çdo grupmall u përcaktua duke përdorur *zgjedhjen tipike propocionale* si mënyra më e përshtatshme për rastin tonë me të dhëna të grupuara. Konkretisht, formula e përdorur për të llogaritur vëllimin e zgjedhjes është:

Ndërsa, për çdo grupmall përfaqësimi me pyetësorë u llogarit si më

$$n = \frac{4 * 1.96^2 (Pgr)(1 - Pgr)}{E^2}$$

poshtë:

² Pyetësorin do ta gjeni në aneksin bashkëngjitur.

$$n_i = \frac{n * N_i}{N}$$

Ku: n përfaqëson numrin e përgjithshëm të deklaratave të zgjedhura për vrojtim; P_{gr} pesha e çdo grupmali (98 grupmallrat sipas Sistemit të Harmonizuar të klasifikimit të tregtisë) në totalin e përgjithshëm tregtar (import ose eksport), N numri i përgjithshëm i deklaratave disponibël; E gabimi i lejuar (5%); n_i madhësia e zgjedhjes për çdo grupmall.

U përfshinë për përfaqsim me një deklaratë edhe grupmallrat me peshë të vogël. Si rrjedhim, vëllimi i zgjedhjes në eksporte dhe në importe u caktua, përkatësisht, në 158 dhe 299 pyetësorë. Pikat ku do të zhvillohej intervistimi u përcaktuan në bazë të shpërndarjes së tregtisë së jashtme sipas pikave të hyrjes dhe të daljes. (Tabela 1 dhe 2 në aneksin bashkëngjitur).

3. *Trainimi i intervistuesve.* Në bazë të kontratës së vendosur mes Bankës së Shqipërisë e INSTAT intervistimi u krye nga ky i fundit. Paraprakisht intervistuesit e ardhur nga rrethe të ndryshme të vendit, që përkonin me pikat e intervistimit, u kontaktuan nga ne për një trainim në ambientet e INSTAT. Gjatë trainimit intervistuesit u njohën me rëndësinë që ka plotësimi i saktë i pyetësorit për Bilancin e Pagesave, duke u ndalur në çdo rubrikë të tij për qartësimet e nevojshme. Gjithashtu, ata u njohën me konceptet e kredisë tregtare si dhe të ciklit tregtar, koncepte për të cilat kërkohet informacion në pyetësor. Intervistimi u shtri në periudhën një mujore, shtator 2002.
4. *Hedhja e informacionit dhe pastrimi i tij.* Hedhja e informacionit u krye nga operatorët e sektorit të informacionit në Departamentin e TI. Të vlefshëm rezultuan 152 pyetësorë në eksporte dhe 302 pyetësorë në importe (Tabela 1 në aneksin bashkëngjitur). Të pavlefshëm janë konsideruar pyetësoret që kanë ardhur në Bankën e Shqipërisë të paplotësuar, me sqarimin mungesë mallrash.
5. *Përpunimi statistikor dhe analiza e rezultateve.* Në përpunimin e pyetësorëve të plotësuar sipas rubrikave janë shfrytëzuar formularët që përmbajnë informacione për rubrikat përkatëse, pavarësisht nëse japin apo jo informacion për rubrikat e tjera.

REZULTATET E DALA NGA ANALIZA SISTEMATIKE E RUBRIKAVE

Informacion i përgjithshëm

Nga pyetësorët e shpërndarë dhe të kthyer, pyetësorë të vlefshëm për llogaritje dhe nxjerrje rezultatesh u vlerësuan 152 në eksporte dhe 302 në importe. Tabela 1, në aneksin bashkëngjitur, jep numrin e pyetësorëve të kërkuar si dhe numrin e pyetësorëve të plotësuar për çdo grupmall. INSTAT sqaron se mosplotësimet përgjatë grupmallrave kanë ardhur si pasojë e mungesës së trasaksioneve tregtare për atë grupmall gjatë periudhës së vrojtimit.


Rubrika I. Të dhëna të përgjithshme mbi transaksionin tregtar me jashtë

Kjo rubrikë ka karakter informues duke synuar dallimin e transaksioneve në importe dhe eksporte, pikave doganore të hyrjes apo të daljes së mallrave, kodit doganor të mallit, vlerën e transaksionit (në Lekë) si dhe vendin destinacion të mallit në rastin e eksportit dhe vendin e importit dhe të origjinës. Infomacionet e mësipërme gjenden në deklaratën doganore, që plotëson i intervistuari (në rastin tonë tregtari) në pikën doganore. Të intervistuarit u kanë dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërmë në 100 për qind të rasteve të vrojtuar.


Në grafikët e mëposhtëm jepet një informacion i përgjithshëm lidhur me volumin e transaksioneve (në fob dhe cif) të rezultuara nga vrojtimi.

EKSPORT


PIKA DOGANORE



SHPËRNDARJA SIPAS GRUPEMALLRAVE




TREGTIA SIPAS PARTNERËVE




IMPORT


PIKA DOGANORE



SHPËRNDARJA SIPAS GRUPEMALLRAVE



TREGTIA SIPAS PARTNERËVE



Rubrika II. Të dhëna për transportin e mallrave

Kjo rubrikë synon të mbledhë informacion për raportin e kostos së transportit të mallit në vlerën e transaksionit, mënyrën e financimit të saj nga palët (rezidentë dhe jorezidentë), si dhe për mënyrën transporti (ajror, detar apo rugor). Mbledhja e informacionit dhe llogaritja e një kostoje përfaqësuese transporti në importe, së bashku me llogaritjen e kostos së sigurimit për mallrat e importuara, përbën qëllimin kryesor të ndërmarrjes së këtij vrojtimi.

Transaksioni tregtar: Import

Tabela e mëposhtme jep informacion mbi mënyrën e financimit të kostos së transportit në rastin kur malli importohet. Në gjashtë raste nga 302 rastet të vlefshme, të intervistuarit nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje. Në mëse 71.5 për qind të rasteve kosto e transportit është përballuar nga pala shqiptare.

Tabela 1. Statusi i ndërmarrjes sipas origjinës.

	Mundësitë	Raste	Përqindjet
Raste pa përgjigje		0	0.0
Raste të vlefshme	Nd/je e përbashkët	614	46.1
	Nd/je e huaj	719	53.9
	Totali	1333	100.0

Të pyetur për përqindjen që zë kosto e transportit në vlerën e transaksionit të intervistuarit kanë dhënë përgjigje në 210 raste nga 302 raste të vlefshëm në importe. Tabela e mëposhtme paraqet statistikën përshkruese të kostos së transportit të llogaritur sipas mesatares së thjeshtë aritmetike mbi bazën e 210 rasteve me përgjigje.


Tabela 2. Kosto e transportit në importe.

Raste	Të vlefshme	210
	Mungojnë	92
Mesatarja		10.58
Gabimi nga mesatarja		0.59
Devijimi standart		8.51
Asimetria		2.628
Ekcesi		8.541
Minimumi		2
Maksimumi		60

Kostoja e transportit e llogaritur me mënyrën e mesatares së thjeshtë rezulton 10.58% e vlerës së mallit. Duke pranuar këtë kosto mesatare gabimi që bëhet është mesatarisht 0.59, pra kostoja mesatare e transportit të mallit për të gjitha rastet do të ndryshojë nga ajo e zgjedhjes me rreth 0.59% të vlerës së mallit. Po të

kemi parasysh se ky gabim zë 5.6 për qind të mesatares, statistikisht do të ishte më i pranueshëm një raport më i vogël.

Devijimi standart rezulton i madh (8.51). Kjo bie më tepër në sy nëse e shprehim madhësinë e tij si përqindje për njësi të mesatares që do të thotë 80 për qind e saj. Pra variacioni i lidhur me koston e transportit të mallit është i madh. Si rezultat mund të themi se, për shkak se tërësia e studiuar nuk është homogjene, mesatarja e thjeshtë nuk është përfaqësuese. Gjithashtu, asimetria dhe ekresi kanë vlera të larta. Kjo mund të vihet re edhe nga histograma e ndërtuar, e cila paraqet frekuencën e përgjigjeve sipas kostove të transportit në 210 rastet me përgjigje për kosto transporti. Rastet janë studiuar në intervale kostoje, nga ku shihet se rastet më frekvente rezultojnë në intervalin 6-11 %.



Kostoja e transportit ndryshon midis mallrave duke u luhatur nga 2% në 60% të vlerës së mallit. Për këtë arsye, krahas analizës horizontale të koston brenda një grupmali (sipas klasifikimit HS në disagregim dy shifror), për llogaritjen e koston mesatare të transportit u zbatua ponderimi vertikal i kostove të mallrave. Në këtë ponderim secilit grupmall iu dha pesha që ka në totalin c.i.f. të vlerës së mallrave të tregtuar.

Gjatë nxjerrjes së mesatareve për çdo grupmall u tregua kujdes i vecantë për normalizimin e kostove brenda grupmallit duke eliminuar kostot ekstreme minimale dhe maksimale.

Nga ana tjetër, duke qenë se nga vrojtimi disa grupmallra rezultuan pa informacion lidhur me koston e transportit (kjo për arsye të mungesës së transaksionit për këto mallra gjatë periudhës së intervistimit apo për mos përgjigje nga ana e të pyeturve) për këto grupmallra u përcaktua një kosto transporti e deduktuar nga grupmali me karakter më të përafërt i përfshirë në vrojtimit.

Kostoja mesatare e ponderuar e transportit të mallrave e llogaritur sipas kësaj mënyre rezulton 12.05 për qind.

Intervali i besimit për këtë kosto mesatare rezultoi në nivelin +/- 1.5 përqind.

Duke iu referuar Tabelës 3 në aneks, ku krahas kostove të transportit për grupmallrat janë të dhëna edhe peshat përkatëse të çdo grupmalli në c.i.f, është i konstatueshëm fakti që impakti i kostove të larta të një sërë grupmallrash zbutet në mënyrë të konsiderueshme nga peshat relativisht të ulta të këtyre grupmallrave.

Të pyetur për mënyrën e transportit, të intervistuarit në masën 85.8 për qind janë përgjigjur për transport rrugor.

Tabela 3. Mënyra e transportit në importe.

	Mundësitë	Raste	Përqindjet
Raste të vlefshme	Ajror	21	7.0
	Detar	22	7.3
	Rugor	259	85.8
	Totali	302	100.0

Për mungesë informacioni nuk mund të llogarisim një koeficient mesatar përgjithësues për koston e transportit ajror dhe detar.

Për të marrë një vlerësim lidhur me kostot e gjetura të transportit (nga vrojtimi) dhe koston që sektori aplikon aktualisht (7 për qind) mbi totalin e vlerës CIF të importit, u kontaktua si me agjensi që operonin në transportin detar ashtu edhe në ato të transportit rrugor. Informacionin do ta gjeni në shtojcën nr.1 në fund të kësaj rubrike.

Transaksioni tregtar: Eksport

Tabela e mëposhtme jep të dhëna mbi financimin e koston së transportit. Vetëm një rast është pa përgjigje. Në 69 për qind të rasteve kosto e transportit është përballuar nga pala shqiptare dhe në 27 për qind të tyre nga pala e huaj. Për pjesën e mbetur (3.3 për qind) kosto është përballuar pjesërisht nga të dy palët.

Tabela 4. Nga cila palë është përballuar kosto e transportit, në eskport.


	Mundësitë	Raste	Përqindjet
Raste pa përgjigje		1	0.7
Raste të vlefshme	Pala shqiptare	105	69.1
	Pala e huaj	41	27.0
	Pjesërisht	5	3.3
	Totali	152	100.0

Të pyetur për përqindjen që zë kosto e transportit në vlerën e transaksionit, të intervistuarit janë përgjigjur vetëm në 105 raste ose 69 për qind e të pyeturve.

Kosto mesatare e transportit sipas mesatares së thjeshtë aritmetike rezulton 9.21 për qind e vlerës së transaksionit. Edhe në këtë rast, ashtu si në importe, statistikatat përshkruese të tabelës së mëposhtme, si dhe paraqitja sipas histogramës tregojnë se mesatarja e thjeshtë aritmetike nuk është përfaqësuese.

Tabela 5. Kosto e transportit në eksport.

Raste	Të vlefshme	105
	Mungojnë	47
Mesatarja		9.21
Gabimi nga mesatarja		0.38
Devijimi standart		3.91
Asimetria		1.176
Ekcesi		1.431
Minimumi		2
Maksimumi		22



Duke ndjekur të njëjtën mënyrë llogaritjeje së koston së ponderuar të transportit përftojmë një kosto transporti në eksporte në nivelin 8 për qind.

Të pyetur për *mënyrën e transportit* të intervistuarit kanë dhënë përgjigje në 100 për qind të rasteve. Në 92.1 për qind të rasteve transporti rezulton rrugor (duke përfshirë këtu edhe kamionët e transportuar nga deti).

Tabela 6. Mënyra e transportit në eksport.

	Mundësitë	Raste	Përqindjet
Raste të vlefshme	Ajror	5	3.3
	Detar	7	4.6
	Rugor	140	92.1
	Totali	152	100.0

Për mungesë informacioni nuk mund të llogarisim një koeficient mesatar përgjithësues për koston e transportit ajror dhe detar.

Shtojcë 1. Takime të zhvilluara me agjensitë e transportit të mallrave në Shqipëri.

Për të marrë një vlerësim lidhur me kostot e gjetura të transportit (nga vrojtimi) dhe koston që sektori aplikon aktualisht (7 për qind) mbi totalin e vlerës c.i.f. të importit, u kontaktua si me agjensi që operonin në transportin detar ashtu edhe me ato të transportit rrugor. Sipas tyre nuk mund të jepet një ide mbi koston e transportit të shprehur si përqindje ndaj vlerës totale të transaksionit. Një vlerësim të përafërt për këtë mund ta japë vetëm tregtari (eksportuesi apo importuesi).

Agjensitë e *transportit detar* informojnë se në këtë lloj transporti shitet kubatura e anijes. Gjithashtu, kosto e këtij lloj transporti është në varësi të distancës. Në raste të veçanta kosto e transportit varet edhe nga lloji i mallit të transportuar p.sh. karburantet përfaqsojnë mallra të rezikshëm, kështu që, në transportin e tyre aplikohen tarifa më të larta se në transportin e mallrave të tjerë.

Psh. Nga Pireu (me anije) deri në Durrës 1 ton karburant transportohet për 25 USD dollarë, ndërkohë që, për mallra të përgjithshëm 1 ton transportohet për 10 USD dollarë. Kontenieret paguajnë për copë.

Për të patur një ide më të saktë lidhur me kostot e transportit të aplikuara sipas distancave, sektori kërkoi një ndarje të tarifave të transportit sipas zonave në Itali dhe Greqi që këto agjensi aplikojnë:

Për Italinë:

Zona e jugut: 6 USD dollar për ton

Zona e qendrore: 8 USD dollar për ton

Zona e veriore: 11 USD dollar për ton

Për Greqinë:

Zona më e afërt : 8 USD dollar për ton

Zona më e largët: 12 USD dollar për ton

Për të njëjtin mall nga e njëjta distancë kosto e transporti detar vlerësohet 2-3 herë më e ulët se ajo e transportit rrugor.

Disa nga shembujt e marrë, ku kosto e transportit varen nga tonazhi i anijes dhe distanca:

Një anije 200 toneshë kërkon rreth 7200 \$ për transport.

Mineralet, të transportuara me një anije 2000 tonësh: 7-8 \$ nga Italia.

Drithrat 10-11\$ për ton nga Sllovenia.

Një kontenier (20' = 36m³) paguan 800-1000 \$ nga Trieste (IT).

Çimento 8.5-10\$ për ton nga Pireu.

Në *transportin rrugor* (me trailera) për transporte nga veriu i Italisë një trailer (28 tonësh) transporton me tarifën 2169-2440 euro; nga zona e mesme 1898-2061 euro; zona e jugut 1627-1898 euro.

Me Greqinë ndeshen tarifën e mëposhtme:

Për distancën më të afërt: 1079 euro

Për distancën më të largët: 1541 euro

Një tjetër interesim i yni në këto takime ishte mbledhja e informacionit mbi operatorët që veprojnë në fushën e transportit, për të patur një ide sa më të saktë të ndarjes së këtij tregu mes firma rezidente dhe jorezidente të transportit. Ky informacion shërbeu si bazë në përllogaritjen e koeficientëve që do të aplikohen në nxjerrjen e *shërbimeve të ofruara dhe të paguara* për transportin e mallrave (shih Box. në Aneks 1).

Përfundime

Kostoja e transportit në importe, e nxjerrë si rezultat i vrojtimit, është 12.05 për qind e vlerës së mallit, pra 72 për qind më e lartë se kostoja prej 7 për qind e vlerës së mallit që aplikohet aktualisht në Bilancin e Pagesave.

Si mund të shihet, kjo është kosto mjaft e lartë, sidomos po të marrim parasysh që kostoja e transportit për vendet e BE është rreth 5 për qind e vlerës së mallit³. Si arsye kryesore për këtë mund të përmendet fakti që, për shkak të tregut të vogël të brendshëm, sasia e mallit të tregtuar është relativisht e ulët dhe nuk lejon që të përfitohet nga ekonomitë e shkallës në transportim. Duke qenë se sasia e mallit të tregtuar është relativisht e vogël, përqindja e kostos së transportit në vlerën e mallit mbetet e lartë.

Një tjetër arsye për mosshfrytëzimin e ekonomive të shkallës dhe koston e lartë të transportit është fakti që transporti i rreth 86 për qind të sasisë së mallit të importuar është i kategorisë së transportit rrugor. Në këtë kategori klasifikohet edhe transporti i mallrave që transportohen me kamiona në tragete. Transporti rrugor ka kosto relativisht të lartë në krahasim me atë detar.

Edhe karakteristikat fizike të produkteve si dendësia, volumi dhe prishshmëria e tyre mund të kenë një impakt mbi transportin dhe koston e tij. Mallrat e grupimit ushqim, pije e duhan kanë peshë të rëndësishme në listën e mallrave të importuara nga ekonomia shqiptare. Këto janë mallra konsumi me mundësi të lartë prishje, kalbje e dekompozimi dhe fakti që një përqindje e caktuar e tyre prishet gjatë transportimit duke ulur vlerën finale të mallit të tregtuar rrit koston e transportit për njësi të këtyre mallrave. Ndër mallrat me peshë të lartë në vlerën totale të importeve janë edhe produktet tekstile. Duke qenë se vlera finale e këtyre produkteve është relativisht e ulët dhe sasia e importuara relativisht të vogla (kompanitë që merren me përpunimin e tekstileve në Shqipëri janë kryesisht ndërmarrje të vogla e të mesme) kostoja e transportit e këtyre mallrave është relativisht e lartë në raport me vlerën e tregtuar.

Rubrika III: Të dhëna për sigurimin e mallrave

Kjo rubrikë ka synuar të mbledhë informacion mbi sigurimin e mallrave në tregtinë e jashtme, informacion sasior mbi përqindjen që zë kosto e sigurimit të mallit në vlerën e trasaksionit si dhe informacion për vendin e rezidencës së institucionit ku është siguruar malli. Siç është përmendur edhe më sipër llogaritja e kostos së sigurimit të mallrave që importohen krahas me llogaritjen e kostos së transportit të importit të mallrave përbëjnë qëllimin final të këtij vrojtimi.

³ Duke iu referuar raportit të EUROSTAT Tetor 2001, *CIF/FOB Adjustment at EU level*.

Transaksioni tregtar: Import

Në importe pyetja “e keni siguruar mallin?” ka marrë përgjigje negative në pjesën më të madhe të intervistave të vlefshme, në rreth 77.8 për qind. Dy raste rezultuan pa përgjigje.

Tabela 7. Sigurimi i mallit.

	Mundësitë	Raste	Përqindjet
Raste pa përgjigje		2	0.7
Raste të vlefshme	PO	65	21.5
	JO	235	77.8
	Totali	302	100.0

Shqipëria përfaqëson rezidencën e rasteve më të shpeshta në sigurimin e mallrave, e ndjekur pas nga Gjermania dhe Italia.

Tabela 8. Vendi i rezidencës ku është siguruar malli.

	Mundësitë	Raste	Përqindjet	
Raste pa përgjigje		2	3.1	
Raste të vlefshme	Shqipëri	31	47.7	
	Gjermani	21	18.5	
	Itali	10	15.4	
	Poloni	2	3.1	
	Zvicër	2	3.1	
	Bullgari	1	1.5	
	Belgjike	1	1.5	
	Qipro	1	1.5	
	Greqi	1	1.5	
	Japoni	1	1.5	
	Rumani	1	1.5	
	Totali		65	100.0

Në tabelën e mëposhtme paraqiten statistikat përshkruese në llogaritjen e kostos mesatare të sigurimit të mallrave për 64 ratet e vlefshme nga 65 raste me sigurim malli.

Tabela 9. Kosto e sigurimit të mallrave.

Raste	Të vlefshme	64
	Mungojnë	1
Mesatarja		1.55
Gabimi nga mesatarja		0.34
Devijimi standart		2.74
Asimetria		5.691
Ekcesi		34.891
Minimumi		0.8
Maksimumi		20

Kosto e sigurimit të mallit llogaritet në nivelin 1.5 për qind të vlerës së transaksionit. Variacioni lidhur me koston e sigurimit të mallit është i madh.

Kosto minimale haset në nivelin 0.8 për qind të vlerës së transaksionit dhe kosto maksimale në nivelin 20 për qind. Si rezultat mund të themi se, për shkak së terësia e studiuar nuk është homogjene, mesatarja e thjeshtë nuk është përfaqësuese. Gjithashtu, asimetria dhe eksesi kanë vlera të larta. Kjo mund të vihet re edhe nga histograma e ndërtuar, e cila paraqet frekuencën e përgjigjeve sipas kostove të sigurimit në 64 rastet e vlefshme. Rastet janë studiuar në mesatare intervali nga ku shihet se rastet më frekvente rezultojnë në 1.3 për qind.

Nga takimet e zhvilluara me agjensitë e sigurimit të mallrave, këto të fundit nënvizuan faktin se ato punojnë me tarifa ndërkombëtare në sigurimin e mallrave. Rrjedhimisht, sigurimi i mallit brenda apo jashtë vendit nuk do të kishte diferencë në vlerën e shërbimit.

Sikurse shihen edhe nga tabela e mëposhtme në rastet më frekvente kosto e sigurimit të mallrave është në nivelin 1 për qind e vlerës c.i.f të transaksionit.




Tabela 10. Kosto e sigurimit të mallit sipas vendeve ku është kryer sigurimi, rastet e dala nga vrojtimi.

KOSTO E SIGURIMIT NË VLERËN E TRANSAKSIONIT		Kostot e ndeshura (%)						Total
		0.8	1	2	8	10	20	
Raste pa përgjigje			2					2
Raste me përgjigje	Shqipëri		29	1		1		31
	Bullgari						1	1
	Belgjikë		1					1
	Zvicër		2					2
	Qipro		1					1
	Gjermani	1	10		1			12
	Greqi	1						1
	Itali		10					10
	Japoni	1						1
	Poloni	1	1					2
Total		4	56	1	1	1	1	64

Raste me kosto të lartë sigurimi rezultuan grupmallrat makineri e pajisje (2 raste) dhe filamente tekstile (1 rast). Në aneksin bashkëngjitur do të gjeni Tabelën 5, që shpreh frekencat e kostos së sigurimit sipas grupmallrave.

Transaksioni tregtar: Eksport

Pyetjes “e kemi siguruar mallin?”, te intervistuarit i janë përgjigjur pozitivisht 55 raste, duke përfaqësuar 36 për qind të intervistave në eksporte. Në 64 për qind të intervistuarit janë përgjigjur negativisht.

Tabela 11. Sigurimi i mallit.

	Mundësitë	Raste	Përqindjet
Raste të vlefshme	PO	55	36.2
	JO	97	63.8
	Totali	152	100.0

Në 87 për qind të rasteve me sigurim mallrash, ky i fundit është kryer në Shqipëri.

Tabela 12. Vendi i rezidences ku është siguruar malli.

	Mundësitë	Raste	Përqindjet
Raste pa përgjigje		4	7.3
Raste të vlefshme	Shqipëri	48	87.3
	Itali	3	5.4
	Totali	55	100.0

Në tabelën e mëposhtme paraqiten statistikat përshkruese në llogaritjen e kostos mesatare të sigurimit të mallrave për 52 ratet e vlefshme nga 55 raste me sigurim malli.

Tabela 13. Kosto e sigurimit të mallrave, në eksporte.

Raste	Të vlefshme	52
	Mungojnë	100
Mesatarja		1.57
Gabimi nga mesatarja		0.12
Devijimi standart		0.83
Asimetria		1.347
Ekcesi		1.178
Minimumi		0.8
Maksimumi		4

Kosto e sigurimit të mallit llogaritet në nivelin 1.57 për qind të vlerës së transaksionit. Nga histograma e ndërtuar si dhe nga tabela rezultative e kostove

sigurimit sipas vendeve ku është kryer sigurimi i mallrave (Tabela 14) shohim se kostot më frekvente janë ato të nivelit deri në 1 për qind.




Tabela 14. Kosto e sigurimit të mallit sipas vendeve ku është kryer sigurimi, rastet e dala nga vrojtimi.

KOSTO E SIGURIMIT NË VLERËN E TRANSAKSIONIT		Kostot e ndeshura (%)					Total
		0.8	1	2	3	4	
Raste pa përgjgje			2	2			4
Raste me përgjgje	Shqipëri	3	23	12	5	2	45
	Itali		3				3
Total		3	28	14	5	2	52

Në aneksin bashkëngjitur do të gjeni Tabelën 6, që shpreh frekencat e kostove së sigurimit sipas grupmallrave.

Shtojce 2. Takime të zhvilluara me agjencitë e sigurimit të mallrave në Shqipëri.

Gjatë takimeve të zhvilluara me shoqëritë e sigurimit, u bë një prezantim i shkurtër i vrojtimit duke u konsultuar tabelat rezultative të dala prej tij. Gjithashtu, u theksua rëndësia e rezultateve të sakta për hartimin e bilancit të pagesave.

Agjencitë e sigurimit të mallrave nënvizuan faktin se ato punojnë me tarifa ndërkombëtare në sigurimin e mallrave. Rrjedhimisht, sigurimi i mallit brenda apo jashtë vendit nuk do të kishte diferenca në vlerën e shërbimit.

SIGMA jep një interval me koston minimale dhe maksimale të hasur në sigurimin e mallrave: 0.2% - 0.6% të vlerës.

Gjithashtu, një ndarje të tarifave për mallra, sipas një klasifikimi të tillë:

Mallra ushqimore: në një interval 0.3% - 0.45% të vlerës.

Mallra industriale: në një interval 0.2% - 0.3% të vlerës.

Të tjera: në një interval 0.2% - 0.3% të vlerës.

Për mallra (fragile) si porçelane apo të llojit të ngjashëm aplikohen tarifa më të larta, por gjithmonë brenda intervalit të dhënë mësipër.

Gjithashtu, në tarifatat e sigurimit ndikon edhe mënyra e transportit. Shërbimi për sigurimin e mallrave në transport tokësor është më i shtrenjtë se në atë detar.

Ashtu si SIGMA, agjësia SIGAL konfirmoi tarifa të ngjashme në sigurimin e mallrave, duke dhënë një maksimum prej 1% në rastin e sigurimit të qelqeve dhe porçelaneve. Sipas disa shembujve të marrë gjatë bisedës sigurimi i mallrave farmaceutikë ishte rreth 0.4% të vlerës.; sigurimi i metaleve 0.25% të vlerës.

Gjithashtu, SIGAL lidh koston e sigurimit të mallit me distancën që përshkruan ky mall, por gjithmonë duke mbetur nën kufirin maksimal (prej 1%).

Si konkluzion, tarifa e sigurimit të mallrave nuk e kalon 1 për qind të vlerës totale të tij. Kjo të çon në përfundimin se edhe vlera që aktualisht aplikohet në vlerësimin e shërbimit të sigurimit nga sektori (3 për qind) është e lartë.

Rubrika IV: Të dhëna mbi mënyrën e pagesës

Rubrika synon të mbledhë informacion mbi mënyrën si bëhet pagesa e trasaksionit duke ofruar alternativat; përmes bankës, kesh, kredi tregtare dhe të tjera.

Të pyetur mbi mënyrën e pagesës, nga 302 pyetësorë të vlefshëm në importe rezulton se pagesa e trasaksionin në *cash* është më frekvente, në 59 për qind të rasteve. Vetëm 39.4 për qind e të intervistuarve kanë kryer trasaksion përmes bankës. Në 5 raste të intervistuarit nuk kanë dhënë përgjigje.

Tabela 15. Mënyra e pagesës në import.

	Mundësitë	Raste	Përqindjet
Raste pa përgjigje		5	1.7
Raste të vlefshme	Përmes bankës	119	39.4
	Në kesh	178	58.9
	Kredi tregtare	0	0.0
	Të tjera	0	0.0
	Totali	302	100.0

Në eksporte, rastet pa përgjigje të kësaj rubrike janë 2 nga 152 formularë të vlefshëm. Sikurse edhe në importe me kesh është operuar në më të shumtën e rasteve, në rreth 56.6 për qind. Për rastet e marra në vërtetim kjo përqindje është e konsiderueshme, megjithë pretendimin se transaksionet në eksporte bëhen nëpërmjet bankës.

Tabela 16. Mënyra e pagesës në eksport.

	Mundësitë	Raste	Përqindjet
Raste pa përgjigje		2	1.3
Raste të vlefshme	Përmes bankës	64	42.1
	Në kesh	86	56.6
	Kredi tregtare	0	0.0
	Të tjera	0	0.0
	Totali	152	100.0

Në aneksin bashkëngjitur do të gjeni Tabelën 7 dhe 8, të cilat paraqesin mënyrën e pagesës sipas grupmallrave, për rastet e hasura në vërtetim, përkatësisht në transaksione eksporti dhe importi.

Si konkluzion, bizneset shqipëtare akoma nuk janë të familiarizuara me bankat. Në rastet më frekvente në importe tregtia kryhet në *cash*. Gjithashtu, edhe pse pretendohet që transaksionet në eksporte kryhen nëpërmjet bankave, nga vërtetimi, vërejmë se në një masë të konsiderueshme ato janë kryer në *cash*.

Rubrika V: Të dhëna për kredinë tregtare

Rubrika synon shohë nëse përdoret apo jo kredia tregtare në financimin e tregtisë së jashtme. Vrojtimi nuk mblodhi informacion për këtë rubrikë.

Rubrika VI: Intervistë e përgjithshme


1. Cikli tregtar

Rubrika synon matjen e ciklit tregtar të mallit. Me cikël tregtar nënkuptojmë periudhën kohore nga momenti i blerjes së mallit deri në momentin e arkëtimit të vlerës së plotë të tij në mjete monetare.

Për llogaritjen e ciklit tregtar të mallit, në import, janë përgjigjur 283 nga 302 të intervistuarit.

Cikli mesatar tregtar llogaritet në nivelin 49.5 ditë ose rreth 1 muaj e gjysëm.

Histograma e mëposhtme paraqet frekuencat e përgjigjeve për kohëzgjatjen e ciklit tregtar të mallrave, ku ky i fundit është shprehur mesatarisht në ditë.



Cikli tregtar varion në varësi të mallrave. Cikli tregtar rezulton i lartë për grupmallrat makineri e pajisje dhe mjete transporti dhe relativisht i ulët në grupmallrat ushqimorë (tabela rezultative gjendet në aneksin bashkëngjitur).

Sidoqoftë, cilësia e përgjigjeve të kësaj rubrike mund të jetë nën parametrat e kërkuar për shkak të keqkuptimeve konceptuale të tregtarëve lidhur me ciklin tregtar. Një shembull i sa më sipër është hasja e përgjigjeve që e vlerësojnë kohëzgjatjen e ciklit tregtar me 10 vjet apo më tepër, përgjigje të cilat janë eliminuar në përpunimin e kësaj rubrike.

2. Kontrabanda


Ky seksion i vrojtimit ka mbledhur opinione të tregtarëve të intervistuar (të importuesve) mbi prezencën e kontrabandës në aktivitetin tregtar që ata zhvillojnë. Të pyetur mbi ndikimin negativ të kontrabandës në aktivitetin tregtar të intervistuarit janë përgjigjur pozitivisht në rreth 92 për qind të rasteve.

Tabela 17. Kontrabanda pengon aktivitetin tregtar.

	Mundësitë	Raste	Përqindjet
Raste pa përgjigje		1	.3
Raste të vlefshme	PO	279	92.4
	JO	22	7.3
	Totali	302	100.0

Opinionet e tyre mbi prezencën në përqindje të kontrabandës në tregun e brendshëm për mallrat e të njëjtës natyrë me mallin që ata tregtojnë janë dhënë në 192 raste. Histograma e mëposhtme paraqet prezencën e kontrabandës në përqindje të vlerësuar nga vrojtimi (prezantuar me mes intervali). Koefficienti i kontrabandës, llogaritur sipas mesatares së thjeshtë rezulton në nivelin 17 për qind.

Në aneksin bashkëngjitur mund të gjeni tabelën përmbledhëse që shpreh përqindjet e kontrabandës sipas grupmallrave (Tabela 10).



Si konkluzion, kontrabanda është një fenomen i pranishëm. Në 92.4 për qind të rasteve opinionet e të intervistuarve mbi ndikimin negativ të saj në aktivitetin tregtar është pozitiv. Megjithatë, nxjerja e një koeficienti matës të besueshëm të kontrabandës në Shqipëri është një objektivi që tejkalon synimet e këtij vrojtimi.

ANEKS

Tabela 1. Popullata e zgjedhur në vrojtim dhe realizimi i vrojtimit sipas grupmallrave.

HS	ZERI	IMPORT		EKSPORT	
		vellimi i zgjedhjes	te vlefshem per vrojtim	vellimi i zgjedhjes	te vlefshem per vrojtim
1	Kafshet e gjalla	1		1	3
2	Mishi	2	4	1	3
3	Peshku	2	2	3	2
4	Produktet bulmetore	1	2	1	1
5	Produktet me origjine kafshore	1		1	
6	Pemet dhe bimet e tjera te gjalla	1		3	
7	Zarzatet e ngrëshme	5	14	3	2
8	Frutat, arrat dhe lekurat e agrumeve	15	26	6	2
9	Kafe, çaj dhe ereza	2	2	2	2
10	Dritherat	2	4	1	1
11	Produktet e industrise bluajtese; malti, niseshte	4	5	0	
12	Farat vajore dhe frutat me permb. vajore	1		6	1
13	Gomat, rreshirat dhe lenge dhe ekstrakte vegjetale	1	1	2	1
14	Materiale vegjetale qe perdoren per thurje	1	1	0	
15	Vajra dhe dhjamera kafshore apo vegjetale	2	1	2	
16	Ushqimet e pregatitura prej mishit, peshkut	2	1	3	2
17	Sheqernat dhe embelsirat prej tij	2	11	2	
18	Kakao dhe pregatitjet prej saj	1		2	
19	Pregatitjet prej drithrave miell, niseshte qumesht	3	4	2	2
20	Pergatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave	3	3	3	5
21	Pergatite te ndryshme te ngeneshme	1	5	2	
22	Pijet, alkolet dhe uthullat	4	4	2	3
23	Mbetjet dhe kthimet nga ind. ushqimore	1	1	1	
24	Duhani dhe zevendesuesit e perpunuar te tij	2	2	1	1
25	Kriperat, sulfuret, oksidet, materiale suvatuese	5	4	2	3
26	Xeheroret, ngjyrat dhe hiri	1		1	
27	Lendet djegese minerale, vajrat , dyllet minerale	11	11	8	8
28	Kimikate inorganike	2	5	1	1
29	Kimikate organike	2	1	1	
30	Produkte farmaceutike	2	14	1	1
31	Pleheruesit	2	2	1	1
32	Ekstraktet ngjyrorese	0		1	
33	Vajrat thelbesore dhe rreshirat, kozmetike	2	1	1	
34	Sapuni, preparate larese, lubrifikuese, qirinjte	3	6	1	
35	Substanca albuminoidale, tutkallet, enzimat	1	1	1	
36	Eksplozivet, produktet piroteknike,shkrepeset	1	1	1	
37	Mallrat fotografike dhe kinematografike	1	1	1	
38	Produkte te ndryshme kimike	2	2	1	1
39	Plastika dhe artikujt prej tyre	8	10	0	1
40	Gome dhe artikujt te tij	2	3	1	
41	Lekuret e paperpunuara dhe te perpunuara	1	1	2	4
42	Artikujt prej lekure, mallrat e udhetimit	2	1	1	
43	Gezofet dhe qimet artificiale, prodhimet e tyre	1		1	2
44	Druri dhe artikujt prej tij, qymyri i drurit	3	5	11	12
45	Tapa dhe artikujt prej tape	1	1	0	
46	Prodhime thuresh, punime xunkthi dhe kallamash	1		1	1
47	Brumi i drurit, mbetje dhe kthime letre e kartoni	1		1	
48	Letra dhe kartoni, artikujt te brumit te letres	2	2	2	2
49	Produkte te ind. te shtypit, doreshkrime	2	1	1	3
50	Mendafshi	1		0	
51	Qime kafshesh te holla apo te ashpra, pelhura	1	1	1	1
52	Pambuku	1		1	
53	Fibra te tjera tekstile vegjetale, fill letre pelhura	1		0	
54	Filamentet e bera nga njerezit	2	1	1	
55	Fibrat themelore te bera nga njerezit	2	2	1	
56	Mbushe shajak, fijet speciale, spango, litare,kablllo	1	1	1	
57	Qilimat dhe veshje dyshemeje prej tekstile	1	1	0	
58	Pelhura speciale te endura, tapicerite, qendismat	1	1	1	
59	Pelhura tekstile te ngopura, art. tekstil per ind	1	1	0	
60	Pelhura te thurura me nje apo me shume fije	1	1	1	
61	Artikujt te veshjes te thurura	5	5	10	10
62	Artikujt te veshjes jo te thurura	4	2	10	5
63	Artikujt te tjere tekstile, veshje e perdorur, lecka	1	1	0	
64	Veshjet e kembeve, pjeset e artikujve te tille	4	4	7	17
65	Veshjet e kokes dhe pjeset prej tyre	1		1	
66	Cadrat, cadrat e diellit, bastumet, kamzhiket	2	1	0	
67	Puplat dhe pushi, art. me to, lule artificiale	1	1	0	
68	Artikujt guri, allcie, cimentoje, asbesti	2	2	2	5
69	Produktet qeramike	5	5	1	7
70	Qelqi dhe artikujt prej qelqi	2	5	0	1
71	Gure e metale te cmuar, art. e tyre,imitc., monedha	1	1	1	
72	Giza dhe celiku	5	6	0	
73	Artikujt prej gize dhe celiku	6	9	2	3
74	Bakri dhe artikujt prej bakri	1		1	13
75	Nikeli dhe artikujt prej tij	1	1	1	
76	Alumini dhe artikujt prej tij	2	2	1	11

77	*****	0		0	
78	Plumbi dhe artikujt prej tij	1	1	1	
79	Zinku dhe artikujt prej tij	1	1	1	1
80	Kallaj dhe artikujt prej tij	1		0	
81	Metalet e tjera, metalqeramikat, produktet e tyre	1	1	0	
82	Veglat e pajisjet e punes, pjeset e tyre prej metali	1	1	1	
83	Artikuj te ndryshem prej metali baze	1	2	2	2
84	Reaktoret nukleare, makineri dhe pajisje mekanike	35	18	4	2
85	Makineri dhe pajisje elektrike per tinguj, imazh tv	34	17	2	
86	Lokomotiva dhe vagone, binare, pajisje sinjalizimi	1	1	0	
87	Mjetet e transportit te ndryshem nga vagonet	35	33	1	
88	Avjonet, anijet e hapsires, dhe pjeset e tyre	1		1	1
89	Anijet varkat dhe strukturat lundruese	1		1	
90	Instrumentat dhe aparatet optike, pjeset e tyre	2		1	
91	Ore e te gjitha llojeve dhe pjeset e tyre	1		0	1
92	Instrumentat muzikore, pjeset e tyre	1	1	0	
93	Armet dhe municionet, pjeset e tyre	1	1	1	
94	Mobilerite, pajisje dhome,ndertesat e parafabrikuar	3	3	2	
95	Lodrat, te domosdoshmet e tyre dhe te sporteve	1		1	
96	Artikuj te ndryshem te prodhuar	1	2	1	1
97	Veprat e artit, copat e mbledhura dhe antikat	1		1	
98	*****				
	TOTALI	299	302	158	152

Tabela 2. Shpërndarja e tregtisë sipas pikave doganore (ne %).

PORTI		IMPORT	EXPORT
TIRANË	<i>rrugë</i>	0	0
RINAS	<i>aerporti</i>	3	5
DURRËS (Shkozeti)	<i>rrugë</i>	0	0
-PORTI DETAR Durrës	<i>det</i>	1	1
-TRAGETI Durrës	<i>det</i>	35	52
SHKODËR	<i>rrugë</i>	0	0
-BAJZË	<i>hekurudhë</i>	0	0
-HANI I HOTIT	<i>rrugë</i>	1	1
POGRADEC	<i>rrugë</i>	0	0
-TUSHEMISHT	<i>rrugë</i>	3	0
-Q. THANË	<i>rrugë</i>	11	2
GJIROKASTËR	<i>rrugë</i>	0	0
